

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.03.2021*

19.03.2021

Ora 19:59

RENDI I DITËS

Hedhja e shortit për “ Përzgjedhjen e Relatorit të Kërkesës Ankimore nr.5”

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:**

Z. Y. Merkaj: Përshëndetje, pranë KQZ-së është paraqitur kërkesa ankimore nr.5 me ankues Koalicionin Partia Demokratike Aleanca për Ndryshim me objekt të ankimit, kundërshtimi i vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.156 datë 17.03.2021 me objekt për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e listave shumemërore të Koalicionin Partia Demokratike Aleanca për Ndryshim për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021. Sipas nenit 14 të rregullores së KAS-it do të zhvillohet shorti për caktimin e relatorit për anëtarin, për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.5 me vendim të anëtarëve të Kas-it mbledhja për zhvillimin e shortit është caktuar në datën 19.03.2021 në orën 19:30. Vazhdojmë procedurën e shortit. Administrata e KQZ-së ka përgatitur 5 shirita letre dhe 5 gogla me ngjyrë, formë dhe peshë të njëjtë. Në një nga 5 shiritat e letrës është vendosur shkrimi “ Kërkesë Ankimore nr.5” e cila paloset dhe futet në një të prej goglave dhe futet në enën transparente. 4 shiritat e tjerë që janë të bardhë pa shënime palosen dhe futen në goglat respektive, përkatësisht 4 goglat e tjera. Atëherë 5 shiritat janë

*Zbardhi materialin audio
Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.19.03.2021*

futur në goglat me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë në një enë transparente duke qenë se mbledhja zhvillohet pa praninë e anëtarëve të KAS-it. Bazuar në pikën 3 të nenit 14 të rregullores së KAS-it pika “ç” një përfaqësues i KQZ-së do të tërheqi goglat në emër dhe për llogari të anëtarëve të KAS-it sipas rendit alfabetik ngjitës të emrit, tërheqin nga goglat që janë në enë. Sipas rendit alfabetik një përfaqësues i KQZ-së do të tërheqi goglën në emër të zotit Elvin Lako. Pasi trazohen, tërhiqet dhe është shkruajtur “Kërkesë Ankimore nr.5”, domethënë Relatori i Kërkesës Ankimore nr.5 është zoti Elvin Lako. Tërheq goglën 1 - në shirit është Kërkesa Ankimore nr.5, domethënë Relatori i Kërkesës Ankimore nr.5 është zoti Elvin Lako. Vazhdojmë procedurën me hapjen e goglave të tjera. Hapet gogla dhe duket që shiriti është i bardhë, hapet dhe gogla e tretë dhe këtu shiriti është i bardhë dhe pa shënime, vazhdojmë me goglën e katërt e njëjta situatë dhe këtu, pa shënime, po ashtu dhe gogla e pestë, është fletë e bardhë dhe pa shënime. Në përfundim të shortit Administrata e KQZ-së do të bëjë publik rezultatin e shortit nga i cili zoti Elvin Lako është Relatori i Kërkesës Ankimore nr.5, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Silvi Sino*

